

28 maj 2025

Rajoni Azi-Paqësor



Mongolia

Mongolia, dikur një perandori e madhe Euroaziatike nën udhëheqjen e Chinggis Khaan në shekullin e 13-të, u nda në shtete më të vogla Mongole në shekullin e 14-të.

Mongolët përfundimisht u kthyen në atdheun e tyre origjinal në stepat (fusha kodrinore me bar) në shekullin e 17-të dhe që atëherë kanë qënë disa herë nën sundimin Kinez.

Mongolia shpalli pavarësinë në vitin 1911, megjithëse kjo ka qënë shpesh e paqëndrueshme. Mongolia është një nga vendet me popullsi më të ulët në botë. **Kisha e Nazaretasit themeloi punën në Mongoli në vitin 2017.**



92 Anëtarë



7 Kisha Plotësisht të
Organizuara



22 Pastorë të Liçencuar
në 1 Distrikt

LUTJE



- Lutuni për besimtarët e rinj dhe të sapoardhur, besimi i të cilëve po thellohet përmes ngjarjeve si Mbledhja e Shenjtërisë në Mongoli.
- Lutuni për rritje të vazhdueshme në Mongoli dhe që udhëheqës të fortë, të mbushur me Frymën e Shenjtë, të dalin për të udhëhequr kishat dhe për të arritur kombin.
- Lutuni për mençuri dhe aftësi dalluese për udhëheqësit e kishës ndërsa ata janë pionierë të projekteve të reja.

LAVDËRIM



- Lavdi Perëndisë për ata që morën pjesë në Mbledhjen vjetore të Shenjtërisë në Mongoli dhe për transformimin e përjetuar nga fuqia e Frymës së Shenjtë.
- Lavdi Perëndisë për rritjen e ndjeshme nga zero kisha në shtatë dhe për një vizion në zgjerim për 100 pika predikimi në pesë qytete.
- Lavdi Perëndisë për mundësitë për të arritur fqinjët dhe miqtë me perspektiva të reja mbi të vërtetën e Ungjillit dhe mesazhin e shenjtërisë.



Mbledhja Vjetore e Shenjtërisë në Mongoli Forcon Besimin

Imagjinoni të jeni pjesë e diçkaje që jo vetëm transformon jetë, por forcon edhe një komunitet të tërë besimtarësh. Mbledhja vjetore e Shenjtërisë në Mongoli po bën pikërisht këtë.

Mbledhja është më shumë sesa thjesht një pushim - është një kohë për Nazaretasit nga i gjithë vendi që të bashkohen, të lidhen me njëri-tjetrin dhe të rriten në besimin e tyre. Gjatë katër ditëve, më shumë se 300 pjesëmarrës adhurojnë, mësojnë dhe ndërtojnë marrëdhënie, ndërkohë që pajisen për të jetuar si dishepuj të ngjajshëm me Krishtin në komunitetet e tyre.



Ky aktivitet ka një ndikim të thellë tek ata që marrin pjesë. Për shumë prej tyre, ajo bëhet një përvojë që ndryshon jetën. Bayantug, një pjesëmarrës, ndau: "Para Mbledhjes së Shenjtërisë, Krishterimi më dukej konfuz. Por mësimet ishin të thjeshta dhe të qarta, dhe kuptova se Zoti është gjithmonë aty për mua, duke më udhëhequr të jetoj në mënyrën e duhur. Jam mirënjohës që kam gjetur qëllimin e Tij në jetën time.

Për Izilltogtokh, një udhëheqës kishe, takimi solli një kuptim të ri të hirit të Zotit: *"Në fillim, nuk ndihesha rehat me termin 'Mbledhje e Shenjtërisë', por pasi mora pjesë, kuptova se edhe pse jemi mëkatarë, Zoti na thërret të jetojmë jetë të shenjtëruara përmes hirit të Tij. Ne jemi të çmuar për Të."*

Mbledhja e Shenjtërisë është vetëm një shembull i shumë mënyrave se si Kisha e Nazaretasit po rritet nëpër botë. Me një fokus në zhvillimin dhe pajisjen e udhëheqësve të kishave, duke qenë pioniere në shtrirjen e kishave të reja dhe iniciativat e mbjelljes së kishave, misioni i kishës është të bëjë dishepuj si Krishti në të gjitha kombet. Të gjitha brezat inkurajohen të marrin pjesë, dhe Zoti po punon në zemrat e fëmijëve dhe të rinjve, duke sjellë rritje në kuptimin e tyre për identitetin Nazaretas dhe shenjtërisë biblike.

Nëse jeni të interesuar të mësoni më shumë se si mund të kontribuoni në këto përpjekje - qoftë përmes lutjes, vullnetarizmit, dhënies ose thjesht përhapjes së fjalës - ka shumë mënyra për t'u përfshirë. Për më shumë informacion mbi këtë projekt, klikoni [këtu](#).

A mund të shërbeni?

A po ju thërret Perëndia të përfshihenit në misionin e kishës në Rajonin e Azi-Paqësorit? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF.

Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).



17001 Prairie Star Pkwy
Lenexa, KS | 66220 US



KISHA e
NAZARENIT